



Prishtinë, 15 qershor 2015

Kodi i ZRRE-së: V_733_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 14 paragrafi 6 dhe 7 i Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja (në fuqi nga data 11.11.2014); dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Drini i Bardhë, të tipit digë, me kapacitet të instaluar prej 6.5 MW, në lokacionin “Ura e Shenjt”, ZK Xërxë, komuna e Rahovecit, të datës 16.04.2015, të shoqërisë “Edelweiss Energy” SH.P.K., me adresë “Dardania” 1/5, hyrja 2 - Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 15 qershor 2015 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_535_2013 i datës 02 maj 2013, edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht **deri me 02 nëntor 2015**.

A r s y e t i m

- ZRRE, me datë 14.03.2012 nga “Edelweiss Energy” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Drini i Bardhë, të tipit digë, me kapacitet të instaluar prej 6.5 MW, në lokacionin “Ura e Shenjt”, ZK Xërxë, komuna e Rahovecit.
- ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, me datë 02 maj 2013 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_535_2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t’i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkojnë me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqërisë “Edelweiss Energy” SH.P.K., do t’i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- ZRRE me datë 16.04.2015 nga shoqëria “Edelweiss Energy” SH.P.K., ka pranuar Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Drini i Bardhë, të tipit digë, me kapacitet të instaluar prej 6.5 MW, në lokacionin “Ura e Shenjt”, ZK Xërxë, komuna e Rahovecit., edhe për një afat shtesë sipas legjislacionit në fuqi.



- Shoqëria “**Edelweiss Energy**” SH.P.K., në kërkesë e saj ka sqaruar se: janë në proces të kompletimit të dokumentacionit për marrjen e Lejes ndërtimore, ku kanë dorëzuar projektin kryesor me nr. 4683 të datës 15.12.2014(bashkangjitur shkresa). Gjithashtu ka sqaruar se kam pranuar nga Komuna e Rahovecit Konkluzën për plotësimin e dokumentacionit për lëshimin e Lejes Ndërtimore. Ka sqaruar se janë plotësuar dokumentacioni sipas Konkluzës së Komunës së Rahovecit, dhe me shkresë zyrtare nr. KR-SH1-01 të datës 02.03.2015 kanë dorëzuar kërkesën për dhënien e lejes ndërtimore(bashkangjitur shkresën drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit të KK Rahovecit).
- Shoqëria, gjithashtu ka sqaruar se janë në bisedime me komunitetin e fshatrave Xerxe dhe Gegje të Komunës së Rahovecit, për arritjen e marrëveshjeve për lejimin e ndërtimitin e hidrocentralit në fjalë, ku shumë shpejt pritet të finalizohet. Në fund të shkresës ka sqaruar se janë në pritje të mbledhjes së Asamblesë së Kuvendit Komunal të Rahovecit, ku pritet të diskutohet, dhe jemi në pritje të marrjes së lejes ndërtimore. Ka sqaruar se, me lëshimin e lejes ndërtimore menjëherë do të fillohet me realizimin e projektit, pasi që gjeneratorët dhe turbinat i posedojnë,dhe të cilat gjenden në depot përkatëse.
- ZRRE pas analizimit të të gjitha shkresave të bashkangjitura dhe rëndësinë që projekti i till të realizohet ka vlerësuar kërkesës për shtyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Shoqëria “**Edelweiss Energy**” SH.P.K., obligohet që të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Drini i Bardhë, të tipit digë, me kapacitet të instaluar prej 6.5 MW, në lokacionin “Ura e Shenjt”, ZK Xërxë, komuna e Rahovecit, deri me datën **02 nëntor 2015** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.

VI. Pas skadimit të afatit të cekur më lartë, Vendimi V-535-2013 i datës 02 maj 2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.

VII. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar.